



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Kuvendi i Kryeqytetit -Municipality of Prishtina

EKSTRAKT

i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Barazi Gjinore, mbajtur më 30.1.2023, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Leonora Shabani - Bajraktari, Dhurata Jahaj -Retkoceri dhe Gëzim Mehmeti.

E pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Violeta Salihu**, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Barazi Gjinore;**
- 2. Diskutim lidhur me Planin lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (PLVMDHF);**
- 3. Harmonizimi i Planit të veprimit të KBGJ me PLVMDHF si dhe me Planin e zyrës për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore;**
- 4. Përgatitjet për organizimin e aktiviteteve për muajin mars;**
- 5. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Barazi Gjinore.

Pika e dytë

Diskutim lidhur me Planin lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (PLVMDHF)

Violeta Salihu, kryesuese tha se ky plan lokal për mbrojtje nga dhuna veç është finalizuar nga zyrtarët ligjor ku do të shqyrtohet në seancën e nesërme të Kuvendit, kështu që më nuk ka ndryshime, por në ndërkohë ne mundemi me marr rekomandime dhe mundemi me pas plotësim ndryshime më vonë. Rreth këtij plani më konkretisht do të na njofton Premtime Preniqi, e cila ka qenë në cilësinë e koordinatorës së mekanizmit koordinues kundër dhunës

në familje që është bërë në bashkëveprim me të gjithë akterët institucional që e përfshinë këtë mekanizëm me përkrahje të OSBE-së dhe të institucioneve tjera.

Premtime Preniqi tha se Plani lokal i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025 është bërë në harmoni me Planin kombëtar për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhunën ndaj grave 2022-2026 d.m.th i nivelit qendror. Pasi është hartuar Plani i veprimit kombëtar me ndihmën e OSBE-së e cila ka angazhuar një konsulentë, ne si mekanizëm kemi filluar ta hartojmë këtë planin në nivel komunal. Në hartimin e këtij plani kanë qenë të gjitha institucionet të cilat merren në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të cilat e kanë pjesë të punës dhunën në familje, mbrojtjen dhe procedurat e tjera të cilat lidhen me dhunën në familje. Ky plan përfshinë objektivat strategjike ku janë tri objektiva strategjike, mandej kemi objektivat specifike, ku për secilën prej objektivave specifike i kemi aktivitetet të cilat janë të ndara për tri vitet e ardhshme.

Në mungesë të një kodi buxhetor, pjesa më e madhe e aktiviteteve janë të planifikuara edhe përmes donatorëve dhe përmes drejtorive përkatëse. Me donatorët ne veçse kemi filluar të konsultohemi, ku disa nga këta donatorë veç janë të pajtuar p.sh te pjesa e Drejtorisë së Arsimit veç është lidhë një marrëveshje ku realizohen trajnimet me personelin arsimor në lidhje më dhunën në familje si dhe shumë pika tjera. Po ashtu në këtë grup marrin pjesë edhe mbrojtësit e viktimave, kështu që është një grup shumë i përzier që ndikojnë dhe e monitorojnë dhe në një far mënyre na japin shumë mendime dhe pjesë të punës.

Violeta Salihu, kryesuese tha se pasi që veç po e analizojmë dhe lexojmë ne këtë plan të veprimit mandej për ta plotësuar planin vjetor edhe të komitetit i cili sipas analizave gjatë takimeve që kemi bërë me mekanizmin duhet me qenë në përputhje me këtë plan të veprimit, kështu që ne mundemi të bëjmë kërkesë paraprakisht për me marr mjete për ndonjë aktivitet të caktuar, me gjet ndoshta linja buxhetore të cilat kishin mundur të kontribuojnë në organizimin e aktiviteteve edhe të mekanizmit. OSBE-ja është duke mbajtur trajnime, Follow UP si donator do ti ketë disa aktivitete, organizata Siti, kështu që të shohim edhe për aktivitete të tjera. Po ashtu duhet shikuar mundësinë edhe me Drejtorinë e Shëndetësisë se janë disa aktivitete që realizohen përmes kësaj drejtorie dhe të mirëqenies sociale.

Premtime Preniqi tha se ne si shtet në këtë vit duhet të raportojmë për Konventën e Stambollit të cilën e kemi pranuar në tërësi dhe kemi bukur shumë obligime në atë

konventë e cila është bukur voluminoze dhe s' di sa kemi me mund me arrit në qoftë se nuk e kemi një bashkëpunim dhe një buxhet.

Violeta Salihu kryesuese tha se as institucionet tash nuk janë të vetëdijshme për obligimet që i sjell Konventa e Stambollit, p.sh për ish rastin "Krivaqa", një raport i një organizate ndërkombëtare për vrasjen e Marigonës d.m.th është komplet në kundërshtim me Konventën e Stambollit, pasi që asnjë vrasje nuk duhet me pas elemente mbrojtëse kur ka të bëjë me çështje nderi, e në këtë rast gjykatësi ka bërë shkelje dhe ka veprua në kundërshtim me

Konventën e Stambollit. Tash të gjitha këto rastet e fundit nuk janë gjykuar ashti si duhet dhe janë në kundërshtim me Konventën e Stambollit të cilat kanë me u paraqit në raportim të organizatave ndërkombëtare.

Ne gjithashtu me gjykatat kemi probleme, ato janë duke i bojkotuar mbledhjet e mekanizmit, po ashtu edhe prokuroria.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se këta mekanizma të shtetit nuk i kushtojnë fort rëndësi barazisë gjinore për at as nuk e shohin të arsyeshme të vijnë, duke mos i dhënë prioritet as trajtimit të rasteve të dhunës.

Premtime Preniqi tha se sa i përket lajmërimit të rasteve ngriti shqetësim duke cekur se policia duhet të lajmërohet e para për rastin në fjalë, kështu që është për tu habitur me gjithë këto trajnime, fushata, media, internet që sa herë hasë në këto raste dhe mos të jepen informata mendoj se kjo nuk qëndron.

Violeta Salihu kryesuese ishte e mendimit se në rast të dhunës familjare mjeku vetëm duhet ta bënë ekzaminimin, dhënien e terapisë e mandej policia vazhdon tutje dhe merret me trajtimin e rastit.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se ne si komitet mundemi me propozuar rritjen e numrit të punëtorëve social, sidomos kur lajmërohet te fëmija dhuna, atëherë ajo është edhe te gruaja, pra në qoftë se fëmija është duke përjetuar dhunë dhe abuzohet fëmija me dhunë dihet që edhe nëna e tij është duke e përjetuar të njëjtën. Kështu që është mirë me pas punëtor social nëpër shkollat tona, nëpër qendra të mjekësisë familjare, ku nuk ka nevojë doktori as me thirr policinë, por veç e raporton te punëtori social, pra me pas një zyre të veçantë edhe nëpër qendra të mjekësisë familjare.

Gëzim Mehmeti tha se në momentin kur të bëhet në mënyrë të drejtë çështja e numërimit statistikor të banorëve zyrtar të regjistruar, ajo e aplikon automatikisht numrin që e vendos qeveria, mirëpo sipas disa të dhënave të tjera del se Prishtina i ka më se 300 mijë banor kështu që aty duhet të shikohet numri me statistikë të re atëherë mundet me u rritë numri i të punësuarve. Gjithashtu mendoj se pa angazhim voluntar edhe të gjinisë mashkullore vetëm sociali nuk mund të bënë zgjidhje, në asnjë vend në botë këtë problematikë se ka zgjedhë sociali. Çështja e voluntarizmit

që e bëjnë shumë femra jashtë, që pas orarit të punës angazhohen, por që të angazhohen edhe voluntarët duhet me pas një kompensim për at angazhim.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se rritja e numrit të dhunës në familje ka të bëjë më shumë edhe me vetëdijesim, se dhunë gjithë ka pas, por se kanë treguar se dhunën gati në çdo familje e ke pasur, çdo në të dytën familje gjithmonë ke pas dhunë, por tani ka filluar të tregohet dhuna që e i paraprijnë shumë shkaktar.

Dhurata Jahaj-Retkoceri tha se në rast te lajmërimit te dhunë familjare për viktimën e ardhmja është e pa sigurt, pasi që ajo veç e lajmëron çka më pas, ajo ekonomikisht mund të pësoj, kështu që shteti nuk e mbron në asnjë formë.

Pika e tretë

Harmonizimi i Planit të veprimit të KBGJ me PLVMDHF si dhe me Planin e zyrës për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Violeta Salihu kryesuese tha se këtë pikë të rendit të ditës do ta diskutojmë në mbledhjen e radhës së komitetit.

Pika e katërt

Përgatitjet për organizimin e aktiviteteve për muajin mars

Violeta Salihu, kryesuese tha se për muajin mars kemi menduar që të paktën ti kemi disa aktivitete dhe me i quajtura "Java e gruas", por për këto aktivitete nevojiten mjete buxhetore.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se zakonisht për muajin mars që është "Java e gruas" ne mundemi të organizojmë ndonjë aktivitete p.sh ndonjë vizitë nëpër shkolla, ku këtë lloj të vizitave ne e kemi pasur edhe në mandatin e kaluar. Po ashtu ka pasur edhe aktivitete me një pankartë në Komunën e Gjilanit ku ka qenë e shkruar " nuk dua lule por dua të drejta", me ndonjë moto se nuk dua ta festoj.

Premtime Preniqi ishte e mendimit që si komitet ti bëhet vizitë atyre grave që kanë dhënë kontribut, ato që janë në pension.

Violeta Salihu, kryesuese tha se do të ishte mirë me i bërë një apo dy pano me i vendos diku në shesh dhe me qëndruar një kohë aty, ne si komitet me dal me i ftuar edhe grupin e asamblistëve gra dhe me i marrë disa mesazhe në shesh nga gratë dhe vajzat, mandej ato mesazhe me i klasifikuar që me i shkruar në pano, por paraprakisht duhet te merret leje nga Komuna për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Po ashtu më 8 mars për "Ditën e gruas" mbledhja mos me qenë solemne me fol vetëm për solemnitet, por me dal me një raport, me qenë një ditë me raportuar për gruan, sa gra janë punësuar në Komunën e Prishtinës, prej kur ka filluar ky mandat

qeverisë, sa gra janë ngritur në pozitë, pra të raportohet për gjendjen e përgjithshme të gruas.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e komitetit
Violeta Salihu

